



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:178577

Datë: 25.04.2024

Numri i dokumentit: 05620510

C.nr.1643/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Afërdita Mulhaxha, në çështjen kontestimore të paditësit H.M. nga P., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Osman Lajçi, avokat në Pejë, kundër të paditurit V.M., nga Peja, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Bajram Lajqi, avokat në Pejë, për shkak të vërtetimit të drejtës së pronësisë, vlera e kontestit: 1.000€, në seancën e dt.24.04.2024, merr dhe shpall këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË PRANIMIT

VËRTETOHET se paditësi H.M. nga P., është pronarë i ngastrës kadastrale me nr.47./11, në sip. prej 270m², ZK Pejë.

DETYROHET i padituri V.M., nga P., që paditësit t'ia njohë të drejtën e pronësisë në patundshmërinë e cekur si në pjesën I të këtij dispozitivi, dhe të lejojë që e njëjta të regjistrohet në regjistrin e paluajtshmërive, pranë Zyrës Komonale Kadastrale, në Pejë, në emër të paditësit, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi, me dt.17.12.2020, ka ushtruar padi, e më vonë nëpërmes përfaqësuesit të tij sipas autorizimit-Osman Lajçi, avokat në Pejë, me dt.07.09.202,3 ka parashtruar precizimin e padis dhe rregullimin e saj, të ushtruar kundër të paditurit V.M., me bazë juridike vërtetimi i drejtës së pronësisë, duke potencuar se paditësi të paditurin e ka djalin e vëllait të tani të ndjerit R.M..

Paditësi dhe i ndjeri R., kanë blerë një pronë në Pejë, e që evidentohet në emër të të ndjerit R., dhe atë: ngastrën kadastrale me nr.47./10, në sip. prej 230m² dhe ngastrën kadastrale me nr.47./11 në sip. prej 270 m² ZK-Pejë. Ka sqaruar se një kohë kanë jetuar në një bashkësi familjare, dhe e kanë ndarë paluajtshmërin, dhe secili nga ata e posedon shtëpinë e banimit(secili në njërën ngastrë).

Pas nxjerrjes së ekspertizës me ekspert gjeodet me dt.02.06.2023, i autorizuari i paditësit ka bërë precizimin e kërkesë padisë, dhe në seancën e fundit të shqyrtimit kryesor të dt.24.04.2024, ka bërë riprecizimin e kërkesë padisë(*si në dispozitiv të këtij aktgjykimi*), duke deklaruar edhe një herë se kërkesa e paditësit është sipërfaqja prej 270m², dhe se pajtohen që muret eventuale që do t'i ndërton pala e paditur, t'i ketë nën strehën e vetë.

I autorizuari i të paditurit në përgjigje në padi dhe në precizimin e bërë me parashtrësë dhe precizimin e fundit në seancën e shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se në tërësi e pranon të

njëjtin, me çka i ka propozuar gjykatës që të merr aktgjykim në bazë të pohimit, në pajtim me nenin 3, lidhur me nenin 148, të LPK-së, pa mbajtur shqyrtim kryesor.

Duke pasur parasysh faktin se i padituri nëpërmes të autorizuarit të tij e ka pohuar në tërësi kërkesëpadinë e precizuar, dhe meqë në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesat për të cilat palët mund të disponojnë lirisht, dhe faktit se nuk ka pengesa në kuptim të nenit 3.3 të LPK, Gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm, e në kuptim të nenit 148 të LPK vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata nuk vendosi, me që asnjëra nga palët nuk i ka kërkuar, në kuptim të nenit 463.1 të LPK.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË-C.nr.1643/20, me dt.24.04.2024.

Gj y q t a r j a
Afërdita Mulhaxha

KËSHILLA JURIDIKE:

*Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve,
pas marrjes të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.*

Numri i lëndës: 2020:178577
Datë: 25.04.2024
Numri i dokumentit: 05620510